



MEMORANDUM MIRËKUPTIMI

Në mes të

Komunës së Prishtinës, e përfaqësuar nga Shpend Ahmeti, Kryetar i Komunës së Prishtinës (në tekstin e mëtutjeshëm Komuna)

Shoqatës “Down Syndrome Kosova” me seli në Prishtinë (në tekstin e mëtutjeshëm Shoqatat)

dhe

Shoqatës së “Autizmit ” me seli në Prishtinë (në tekstin e mëtutjeshëm Shoqatat)

Neni 1

QËLLIMI

1. Komuna dhe Shoqatat lidhin këtë memorandum mirëkuptimi me qëllim që të ndërtojnë një Qendër për trajtimin e personave me sindromën Down dhe Autizëm.

Neni 2

PËRGJEGJËSITË E PALËVE

Në kuadër të këtij bashkëpunimi secila prej palëve zotohet të zbatojë përgjegjësitë e mëposhtme me qëllim realizimin sa më të mirë dhe efikas të objektivave të këtij bashkëpunimi.

1. Komuna e Prishtinës do të angazhohet për:

- 1.1. Caktimin e lokacionit për ndërtimin e Qendrës për trajtimin e personave me sindromën Down dhe Autizëm .
- 1.2. Sigurimin e një pjese të mjeteve financiare për ndërtimin e Qendrës, e cila do të caktohet në Kontratën e bashkëfinancimit.
- 1.3. Ndërtimi i Qendrës me parimin “çelsat në dorë” në bazë të projektit për të cilin duhet të merret edhe pëlqimi i Shoqatave.
- 1.4. Prezantimi i shpenzimeve të bëra gjatë ndërtimit të qendrës tek Shoqatat.

2. Shoqatat do të angazhohen që:

- 1.1. Mjetet financiare të grumbulluara nga Shoqatat në emër të ndihmave për ndërtimin e Qendrës, të derdhen në llogari të Komunës së Prishtinës me destinim ekskluziv për ndërtimin e Qendrës së lartëcekur.
- 1.2. Të gjitha marrëveshjet eventuale në mes të Shoqatave dhe Kompanive e të cilat janë në funksion të kryerjes së punëve në dobi të Qendrës do t’i prezentohen Komunës.
- 1.3. Shërbimet që ju kanë ofruar shoqatave për ndërtimin e qendrës do të jenë në dispozicion për ndërtimin e Qendrës, shërbime këto që do të ndikojnë në uljen e kostos së ndërtimit.

Neni 3

KONTRATA PËR BASHKËFINANCIM

Kontrata për bashkëfinancim do të lidhet pas prezantimit të projektit dhe përcaktimit të kostos fillestare të tij.

Neni 4

NDRYSHIMI DHE PLOTËSIMI I MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT

Marrëveshja e bashkëpunimit në mes të palëve mund të ndryshohet dhe plotësohet me shkrim në rast nevojë, me pëlqimin e palëve.

Neni 5

PËLQIMI I PALËVE

1. Palët duhet të veprojnë në besueshmëri të plotë për të siguruar arritjen e të gjitha objektivave të marrëveshjes.
2. Mospajtimet ose interpretimet eventuale të ndryshme të pikave të kësaj marrëveshje do të rregullohen në mënyrë miqësore, me marrëveshje konsensuale.

Neni 6

HYRJA NË FUQI

Ky memorandum mirëkuptimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga ana e palëve nënshkruese.

Data: 20.06.2017

Kryetari i Komunës së Prishtinës

Shpend Ahmeti

Shoqata "Down Syndrome Kosova"

Shoqata e Autizmit
